

MOBILITETI I PUNËS/LËVIZSHMËRIA E FUQISË PUNËTORE¹

Ky website ka për qëllim të ofrojë informacion për punëdhënësit, agjencitë e punësimit të përkohshëm, punëtorët dhe punëmarrësit në lidhje me kuadrin ligjor në rastin e dërgimit të punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë².

Bashkimi Evropian në vite ka synuar të plotësojë një kuadër rregullator për të drejtat e punës për punëtorët që dërgohen nga një Shtet Anëtar për të ofruar një shërbim përkohësisht në territorin e një Shteti Anëtar tjetër. Në këtë fushë janë miratuar disa akte, si Direktiva 96/71/KE, Direktiva 2014/67/BE, Direktiva 2018/957/BE dhe Direktiva 202/1057/BE. Qëllimi i tyre, ndër të tjera, është:

- Të garantojnë mbrojtjen e punëtorëve dhe sigurojnë mundësi të barabarta për ofruesit e shërbimeve;
- Të përcaktojnë një listë të kushteve të punës që duhet t'u jepet punonjësve të cilët janë dërguar përkohësisht jashtë vendit nga punëdhënësi i tyre në vendin ku janë dërguar (vendi pritës);
- Të trajtojnë çështje të tilla si abuzimi dhe anashkalimi i rregullave të postimit, përgjegjësinë e përbashkët në zinxhirët e nën kontraktimit dhe shkëmbimin e informacionit midis vendeve të BE-së;
- Të vendosin rregullat në lidhje me kushtet e punës dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve të postuar, dhe kërkon të sigurojë paga të drejta dhe kushte të barabarta ndërmjet postimeve dhe kompanive lokale në vendin pritës, duke ruajtur parimin e lëvizjes së lirë të shërbimeve.
- Të vendosin rregullat në lidhje me kushtet e punës dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve të dërguar;
- Të përcaktojnë rregulla specifike për dërgimin e shoferëve profesionistë në sektorin e transportit rrugor;

Për më shumë shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/LSU/?uri=CELEX:32014L0067>

Shqipëria është tërësisht e angazhuar në procesin e integritit evropian. Integrimi evropian përbën një ndër prioritetet kryesore të vendit. Një ndër detyrimet e këtij procesi është dhe përafrimi dhe harmonizimi i plotë i legjislacionit dhe politikave kombëtare me atë të Bashkimit Evropian. Legjislacioni që rregullon dërgimin e punëtorëve për të ofruar shërbime përbën një nga këto drejtime. Autoritetet kombëtare janë përgjegjëse për të përafruar dhe harmonizuar legjislacionin kombëtar me atë të BE dhe garantuar zbatimin e duhur të tij. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe

¹ Është përdorur terminologjia e përdorur në SKPA. Pas hartimit të gjithë outline -it dhe informacioneve online, para hedhjes për publikim mund të merret një opinion nga KE në Tiranë, duke e dërguar për mendim paraprakisht tek zyra e delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.

² Është përdorur paragrafi i Bullgarisë pasi është i përshtatshëm edhe në rastin tonë.

Inovacionit së bashku me strukturat në varësi të saj, është autoriteti kryesor përgjegjës për përafrimin e këtij legjislacioni.

Strukturat e rëndësishme në varësi të saj dhe që marrin pjesë në këtë proces dhe në vijim ndjekin zbatimin e këtij legjislacioni, janë Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Institucione në nivel qendror të përfshira drejtpërdrejtë janë Ministria e Brendshme dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për më shumë shih [Albania Report 2024.pdf](#)